

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

VARIANTI A

E mërkurë, 1 qershor 2011

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme teknike profesionale (3+2) dhe 5-vjeçare

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	10a	10b	10c	11a
Pikët														
Kërkesa	11b	11c	12a	12b	12c	12d	13	14	15	16	17	18	19	20
Pikët														
Kërkesa	21a	21b	22a	22b	22c	23a	23b	24a	24b	25a	25b	25c	25d	
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

PJESA I**Gjergj Fishta****Shqypnija**

Edhe hana do ta dije,
dhe dielli do t'ket pa,
se për qark ksaj rrokullije
si Shqipnija 'i vend nuk ka!
Fusha t'gjana e kodra t'blerta,
zijes s'mnershme larg ku asht droja,
me gaz t'vet ktu i vesh prendvera,
si t'Parrizit t'larmet shtroja.
Nën një qiellë përherët t'kullueme,
n'rreze e n'dritë përshkue unji,
bjeshkë e male të blerueme
si vigaj shtiellen n'ajri.
Ke ato bjeshkë e ke ato male
kroje t'kjarta e t'cemta gurra,
tue rrëmbye ndër mriza hale,
gurgullojn ndër rrëjë e curra.
Mbi ato male e bjeshkë kreshnike
lejn mande' ata djelm si zana,
armët e t'cilvet, p'rherë besnike,
janë përmendë ndër fise t'tana.
Atje lejn, po, toskë e gegë;
si dy rreze n'flakë t'nji dielli
si dy rre, qi shkojnë tue djegë,
kur shkrep reja nalt prej qielli.
Oh! Po, e din i prujtë anmiku.
se asht rre zogu i shqyptarit,
rijtun gjakut kah çeliku
n'dorë t'ktij shndritë për vend t'të Parit.
Ato male të madhnueshme,
ato, po, kanë mujtë me pa
se sa forca e perfrigueshme
n'turr t'shqyptarit pit ka ra

Dridhet toka e gjimon deti,
ndezen mallet flakë e shkndija,
ka' i frigueshëm, si tërmeti,
atje rrëmben ku e thurret Lirija.
Lume e she para atij ngelin,
ia lshojn udhën dete e male;
mbretent fjalën s'mund t'ia shkelin
turrin ferri s'mund t'ia ndalë.
Shkundu pluhnit pra Shqypni;
ngrehe ballin si mbretneshë,
pse me djelm, qi ngrofë ti n'gji,
nuk mund t'quhesh, jo, robneshë.
Qi zanat ka besë e fe,
për liri, për fron të Mbretit
me dhanë jetën ka ba be,
Sy për sy, po kqyr anmikun;
Përse djelmt, qi ti ke ushqye,
s'i ka pa, jo, kush tue hikun:
Friga e dekës kurr s'i ka thye.
Kaq të bukur, kaq të hieshme
perëndija t'fali i Amshueshem,
sa 'dhe deka asht për ty e shieshme:
n'gji tand vorri asht i lakmueshëm.
Po, edhe hana do ta dije,
edhe dielli do t'ket pa,
se për qark ksaj rrokullije,
si Shqypnija 'i vend nuk ka!
Rrnosh e kjosh, pra moj Shqypni,
rrnosh e kjosh gjithmonë si vera;
e me dije e me Liri
për jetë t'jetës të rrnoftë ty ndera.

Për pyetjet 1-7 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Poezia *Shqypnija* bën pjesë në veprën: **1 pikë**

- A) Gomari i Babatasit
- B) Lahuta e Malcis
- C) Vallja e Parrizit
- D) Mrizi i Zanave

2. Krijimi i mësipërm është i llojit: **1 pikë**

- A) dramatik
- B) epik
- C) lirik
- D) epiko-lirik

3. Motivi mbizotërues i kësaj poezie është: **1 pikë**

- A) udhëtimi
- B) atdheu
- C) miqësia
- D) familja

4. Në vargun: *si dy rrfe, qi shkojnë tue djegë*, është përdorur figura: **1 pikë**

- A) e antitezës
- B) e ironisë
- C) e simbolit
- D) e krahasimit të zgjatur

5. Fjalët *mbretreshë* dhe *robreshë* brenda kontekstit të kësaj poezie shfaqen si: **1 pikë**

- A) antonime
- B) sinonime
- C) homonime
- D) shprehje frazeologjike

6. Poeti i bën thirrje Shqipërisë të qëndrojë kryelartë në vargjet: **1 pikë**

- A) Friga e dekës kurr s'i ka thye.
- B) Ngrehe ballin si mbretreshë.
- C) Ato male të madhnueshme.
- D) Se asht rrfe zogu i shqyptarit.

7. Ç'përcillet në vargun: *Rrnosh e kjosh, pra moj Shqypni, rrnosh e kjosh gjithmonë si vera?*

1 pikë

- A) Urim
- B) Urdhër
- C) Mallkim
- D) Habi

8. Fjalët e mëposhtme i shkruani në variantin letrar. **3 pikë**
kjosh, rrfë, të blerueme

9. Gjeni katër vargjet që përsëriten gjatë poezisë dhe shpjegoni efektin e kësaj përsëritjeje.

- a) _____ **1 pikë**

- b) _____ **1 pikë**

10. Si del në poezi dëshira dhe ideja për përsosjen morale dhe fizike?

- a) _____ **1 pikë**

- b) _____ **1 pikë**

- c) Me cilin poet kombëtar ju ngjan Fishta kur shkruan:
fusha t'gjana e kodra t'blerta,...? **1 pikë**

11. Identifikoni llojin e rimës dhe të vargut në këtë poezi.

Zbuloni një tregues tjetër që dëshmon mbështetjen e Fishtës në krijimtarinë popullore.

- a) _____ **1 pikë**

- b) _____ **1 pikë**

- c) _____ **1 pikë**

12. Argumentoni natyrën romantike të krijimtarisë së Fishtës, duke zbuluar më parë tri kulte të romantizmit në këtë poezi.

- a) _____ **1 pikë**

- b) _____ **1 pikë**

- c) _____ **1 pikë**

- d) _____ **1 pikë**

PJESA II

Alber Kamy

I Huaji (fragment)

Megjithatë, jashtë orët kalonin dhe vapa kishte rënë ca. Nga disa zhurma që dëgjoja nga rruga, merrja me mend ëmbëlsinë e mbrëmjes. Ne ishim aty, të gjithë, në pritje. Dhe ajo që prisnim të gjithë së bashku, kishte të bënte vetëm me mua. Vështrova përsëri sallën. Çdo gjë ishte si ditën e parë. Ndesha shikimin e gazetarit me xhakët gri dhe të gruas automate. Kjo më bëri të kujtohem se gjatë gjithë procesit nuk e kisha kërkuar me sy Marien. Nuk e kisha harruar por kisha qenë shumë i zënë. E pashë midis Çelestës dhe Rajmondit. Ma bëri me shenjë sikur më thoshte: “Më në fund” dhe pashë fytyrën e saj në ankth që buzëqeshje. Por e ndjeja që zemra më shtrëngonte dhe nuk mundesha as t’i përgjigjesha buzëqeshjes së saj.

Trupi gjykues u kthye në sallë. Shumë shpejt u lexuan një seri pyetjesh drejtuar gjyqtarëve. Dëgjova “fajtor për vrasje”... “paramendim”... “rrethana lehtësuese”. Gjyqtarët dolën dhe mua më çuan në dhomën e vogël ku kisha pritur dhe më parë. Avokati im erdhi të më takojë: ai fliste shumë dhe me besim e përzemërsi si asnjëherë tjetër. Ai mendonte se çdo gjë do të shkonte mirë dhe, se unë do t’ia hidhja me disa vjet burg ose punë të detyruar. E pyeta në se kishte mundësi për anulim vendimi po qe se ky nuk do të ishte në favorin tim. Ai më tha se jo. Taktika e tij kishte qenë të mos acaronte jurinë. Ai më shpjegoi se një vendim nuk anulohet, ashtu, për hiç gjë. M’u duk e qartë dhe iu binda arsyeve të tij. Po ta gjykoje me mendje të kthjellët ishte krejtësisht e natyrshme. Në të kundërtën do të kishte shumë fletushka të kota. “Sidoqoftë, më tha avokati im, është dhe lutja për falje. Por jam i bindur se përfundimi do të jetë i favorshëm.”

Ne pritëm një kohë shumë të gjatë, afër tre çerek ore, më duket. Më në fund tringëlli një zile. Avokati im u largua duke thënë: “Kryetari i jurisë do të lexojë përgjigjet. Juve do t’ju fusin brenda vetëm për formulimin e vendimit.” U përplasën dyer. Njerëz vraponin nëpër shkallë dhe nuk e kuptoja në ishin afër apo larg. Pastaj dëgjova një zë të mbytur të lexonte diçka në sallë. Kur zilja ra përsëri dhe u hap dera, heshtja e sallës u ngrit drejt meje, heshtja, dhe me të ndjenja e veçantë që më pushtoi kur vura re se gazetari i ri i kishte hequr sytë nga unë. Nuk vështrova nga Maria. Nuk pata kohë sepse kryetari tha në mënyrë që disi më habiti se do të më prisnin kokën në mes të një sheshi në emër të popullit francez. Atëherë m’u duk se kuptova ndjenjën që lexoja tek të gjitha fytyrat. Mendoj se ishte respekt. Xhandarët ishin shumë të butë me mua. Avokati e vuri dorën mbi dorën time. Nuk mendoja më për asgjë. Por kryetari më pyeti nëse kisha gjë për të shtuar. U mendova. Thashë: “jo”. Atëherë më morën.

Për pyetjet 13-18 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

13. Romani *I huaji* trajton temën e:

1 pikë

- A) heroizmit dhe madhësisë
- B) absurdit dhe fatit njerëzor
- C) ripërtëritjes së jetës
- D) diskriminimit racor

14. Subjekti në veprën *I huaji* të Kamysë karakterizohet nga:

1 pikë

- A) prania e episodeve të domosdoshme
- B) përshkrimi i ngjarjeve deri në imtësi
- C) zhvillime të linjave paralele
- D) mungesa e fabulës së mirëfilltë

15. Në këtë fragment Mersoi mbetet i huaj, sepse:

1 pikë

- A) Maria kërkon ta takojë Mersoin pas dënimit.
- B) ndesh shikimin e Maries në momentin e dhënies së dënimit.
- C) avokati e mbron siç duhet Mersoin.
- D) pret dënimin pa mundur të mbrojë vetveten.

16. Fjala *asnjëherë* është:

1 pikë

- A) e parme
- B) e përbërë
- C) e përngjitur
- D) e prejardhur

17. Ligjërata e zhdrejtë në paragrafin e dytë (kur Mersoi komunikon me avokatin) tregon:

1 pikë

- A) që veprimi po rrjedh shpejt
- B) pamundësinë e Mersoit për të folur
- C) dilemën e Mersoit
- D) që veprimi rrjedh ngadalë

18. Fjalitë: “*Ne pritëm një kohë shumë të gjatë, afër tre çerek ore, më duket. Më në fund tringëlliu një zile*” përcjellin në fragment atmosferë:

1 pikë

- A) ekzaltimi
- B) lumturie
- C) ankthi
- D) qetësie

19. Përse Mersoi ndodhet në sallën e gjyqit? **1 pikë**

20. Arsyetoni mosreagimin e Mersoit ndaj vendimit. Ilustrojeni mendimin tuaj me një shembull nga fragmenti. **2 pikë**

21. a) Zbuloni në fragment dy reagimet e Mersoit në lidhje me Marian. **2 pikë**

b) Çfarë dëshmojnë ato në lidhje me gjendjen shpirtërore të vetë Mersoit? **1 pikë**

22. Vëreni në paragrafin e parë fjalitë ku janë përdorur përemrat *Unë (mua më)* dhe *Ne*.

Kush përfshihet te përemri *Ne*?

Në ç' marrëdhënie vendoset Mersoi me të pranishmit? Shpjegoni këtë në funksion të ngjarjes që ndodh në këtë fragment.

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

c) _____ **1 pikë**

23. Cili është nënteksti i shprehjeve: *Dëgjova “fajtor për vrasje”... “paramendim”... “rrethana lehtësuese”*? Ç'përcjell Kamy te lexuesi nëpërmjet kuptimit që merret prej tyre?

a) _____ **1 pikë**

b) _____ **1 pikë**

24. Ndaluni në paragrafin e fundit dhe tregoni dy shenja që shërbejnë si paralajmërim për vendimin tragjik.

Ç'tipar i stilit të Kamysë del në shprehjet e mëposhtme?

Por kryetari më pyeti nëse kisha gjë për të shtuar. U mendova . Thashë: “jo”. Atëherë më morën.

a) _____ **2 pikë**

b) _____ **1 pikë**

25. Mbështetur në veprën *I huaji*, përshkruani përmes një eseje **vetminë e njeriut përballë botës, në këndvështrimin e kohës së sotme.** 8 pikë

[illegible]

Shtjellimi i idesë (25a)	Organizimi dhe struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (25d)	Totali 25
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë